Në bazë të nenit 17 paragrafi (2) të Ligjit për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikat rinore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 10/2020), nenit 40-b, nenit 40-g dhe nenit 40-d të Statutit të Komunës së Çairit („Fleta zyrtare e Komunës së Çairit“ nr. 5/21), Bordi Iniciativ, në bashkëpunim me Komunën e Çairit, më datë 14.09.2026, shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për nominimin e përfaqësuesve nga format e organizimit dhe bashkimit të të rinjve për formimin e Kuvendit Lokal të të Rinjve

I. Përshkrimi i thirrjes publike

Bordi Iniciativ për formimin e Këshillit Lokal të të Rinjve pranë Komunës së Çairit shpall Thirrje Publike për nominimin e përfaqësuesve për anëtarësim në Kuvendin Lokal të të Rinjve të Komunës së Çairit.

II. E drejta e pjesëmarrjes

Thirrja Publike u drejtohet formave të organizimit dhe bashkimit të të rinjve të përcaktuara me Ligjin për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikat rinore, përkatësisht: organizatave rinore, organizatave për të rinj, forumeve rinore të partive politike, organizatave të nxënësve dhe studentëve dhe formave të tjera të bashkimit të të rinjve.

Format e organizimit dhe bashkimit të të rinjve nuk është e nevojshme të jenë të regjistruara në territorin e Komunës së Çairit, por duhet të zhvillojnë aktivitete në territorin e Komunës së Çairit.

III. Qëllimi i thirrjes publike

Qëllimi i kësaj Thirrjeje Publike është që organizatat rinore, organizatat për të rinj, forumet rinore të partive politike, organizatat e nxënësve dhe studentëve dhe format e tjera të bashkimit të të rinjve të paraqesin kërkesë pranë Komunës së Çairit, me të cilën do të nominojnë përfaqësuesit e tyre (delegatin dhe zëvendësdelegatin), me qëllim të zbatimit të procedurës së përcaktuar me Ligjin për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikat rinore për formimin e Këshillit Lokal të të Rinjve të Komunës së Çairit.

Përfaqësuesit e nominuar në Kuvendin Lokal të të Rinjve duhet të jenë banorë të Komunës së Çairit dhe të jenë të moshës nga 15 deri në 29 vjeç.

IV. Detyra e Kuvendit Lokal të të Rinjve

Kuvendi Lokal i të Rinjve shpall thirrje publike për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Lokal të të Rinjve dhe i zgjedh anëtarët e Këshillit të të Rinjve përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta, me votim të fshehtë, ku të drejtën e votës e kanë delegatët e Kuvendit Lokal të të Rinjve.

V. Dokumentet e nevojshme

Organizatat rinore të interesuara për pjesëmarrje në Thirrjen Publike duhet t'i dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. **Fletëparaqitje për nominimin e delegatit dhe zëvendësdelegatit**, të paraqitur nga organizata rinore (formulari në shtojcë);
2. **Portofol të organizatës, grupit ose shoqatës**;
3. **Raport për punën e organizatës rinore/shoqatës për vitin 2025**, ose dokument tjetër në të cilin janë paraqitur aktivitetet e realizuara me të rinjtë, aktivitetet që lidhen me politikat rinore dhe iniciativat e realizuara në territorin e Komunës së Çairit;
4. **Letër e shkurtër motivimi nga delegati i nominuar dhe biografi e shkurtër**;
5. **Deklaratë për pajtueshmëri për përdorimin e të dhënave personale** (formulari në shtojcë); dhe
6. **Deklaratë për pajtueshmëri nga personat e nominuar për pranimin e nominimit** (formulari në shtojcë).

VËREJTJE: Organizatat që janë pjesë e Bordit Iniciativ, përkatësisht që kanë përfaqësuesit e tyre në Bordin Iniciativ, nuk janë të detyruara t'i dorëzojnë përsëri dokumentet e përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4 (portofolin e organizatës, raportin për punën dhe letrën e motivimit), nëse të njëjtat tashmë janë dorëzuar gjatë procedurës për formimin e Bordit Iniciativ.

VI. Mënyra e dorëzimit të dokumenteve, afati dhe vendi

Të gjitha organizatat rinore të interesuara dhe strukturat e tjera rinore që i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë Thirrje Publike mund të dorëzojnë fletëparaqitjen për nominimin e përfaqësuesve të tyre, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm, në një kopje, të nënshkruar nga personi përgjegjës i organizatës. Dokumentet mund të dorëzohen çdo ditë pune, në periudhën nga ora 08:00 deri në orën 15:30, deri në përfundimin e afatit për dorëzimin e fletëparaqitjeve, në adresën e mëposhtme:

- **Në Arkivin e Komunës së Çairit**, në rr. „Hristijan Todorovski Karposh“ nr. 5.

Dokumentacioni dorëzohet në zarf të mbyllur, të shënuar me:

„Për Thirrjen Publike për formimin e Kuvendit Lokal të të Rinjve“

Nëse dokumentacioni dorëzohet në mënyrë elektronike, në subjektin e mesazhit elektronik duhet të shënohet:

„Për Thirrjen Publike për formimin e Kuvendit Lokal të të Rinjve“

VII. Kohëzgjatja e Thirrjes Publike

Thirrja Publike zgjat 10 (dhjetë) ditë nga dita e publikimit të saj në ueb-faqen e Komunës së Çairit.

VIII. Afati i fundit për dorëzimin e fletëparaqitjeve

Afati i fundit për dorëzimin e fletëparaqitjeve është 23.09.2026, deri në orën 15:30.

IX. Procedura për shqyrtimin e fletëparaqitjeve të dorëzuara

Fletëparaqitjet e dorëzuara dhe dokumentacioni i bashkëngjitur do të shqyrtohen nga Bordi Iniciativ, i cili do të përcaktojë vlefshmërinë e tyre dhe përmbushjen e kushteve dhe kritereve të përcaktuara me këtë Thirrje Publike.

14.09.2026

Komuna e Çairit

BORDI INICIATIV

Muaz Qaili ——————————

Basri Fejzullahi ——————————

Arbnor Maliqi ——————————

Amineja Imeri ——————————

Remzije Abazi ——————————